REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ -MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 05-052-01-19227-24
Nr. i fq. / Br.str. / No.pg.
Data / Datum / Date 25.09.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

**REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**-KOMUNA E OBILIQIT/ OPŠTINAOBILIĆ/MUNICIPALITY OF OBILIQ -**

**Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronës dhe Kadastrit publikon**

# RAPORT MBI ECURIN E PUNËS GJATË SHQYRTIMIT PUBLIK TË DRAFT HZK-së SË KOMUNËS SË OBILIQIT 2024-2032

**në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 neni 12**

Me datë 26.07.2024 është marrë pëlqimi i vendimit per hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor-HZK-së të Obiliqit 2024-2032 nga MMPHI-ja .

SP-02 3841-2/24
02 26.07.24
PRISHTINË

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostorno Planiranje i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planningand Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 26.07.2024 |
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | Arben Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër - Komuna e Obiliqit |
| CC: | Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | **Vendim për pëlqim** për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt- "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032" |

I nderuar z. Berisha,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 (paragrafi 1.9, nën paragrafi 1.9.2) Komuna e Obiliqit ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 14.06.2024 me numër të protokollit 3841/24, kërkesën "për marrjen e pëlqimit për **hapjen e shqyrtimit publik** të Projekt " Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032".
Sipas nenit (9 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3), Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së Projekt "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032" me "Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Faqe1nga2

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Ministria e Mjedisit,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerr Vendim për pëlqim, që Kuvendi i Komunës së Obiliqit sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoritetit Komunal për Planifikimit dhe Menaxhim Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, **Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik.**

Me respekt,

Faqe2nga2

Më datën 26.07.2024 Drejtoria e Planifikim Urban, Pronës dhe Kadastrit iu ka drejtuar me kërkesë Kryesueses së Kuvendit përmes kryetarit, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për të hapur shqyrtimin publik për draft dokumentin Planin Zhvillimor të Komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIQ
Nr Br No 05-104/02-21231/24
Nr i lj / Br str / No pg
Data / Datum / Date 26.07.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

Republika e Kosovës - Republika Kosovo- Republic of Kosova

**Komuna e Obiliqit- Opština Obilić - Municipality Obiliq**

**Drejtoria për Planifikim Urban ,Kadastër dhe Pronë**

| | |
|---|---|
| Datë/Data/Date | 26.07.2024 |
| Nga/Od/From: | Arben Berisha –Drejtor i DPUKP-së |
| Përmes/Preko/Through: | z.Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës |
| Për/Za/To: | Znj.Vlora Mjekiqi Kabashi – Kryesuese e Kuvendit Komunal |
| Tema/Subjekat/Subjeckt: | Kërkesë për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme |

E nderuar !

Fillimisht ju njoftojmë se bazuar në legjislacionin në fuqi Komuna e Obiliqit është në fazën finale të projekt Hartës Zonale të Komunës së Obiliqit 2024-2032 .

Me datë 14.06.2024 kemi bërë kërkesën me nr. protokolli V-104-02-16994-24 në Ministrinë e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përkatësisht në Departamentin e Planifikimit Hapësinor për marrje të vendimit për pëlqim për miratimin e dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032", me datë 25.05.2023 kemi pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përkatësisht Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm *Vendimin Njësia Org.SP-02; Nr.prot 3841-2/24 Dt.26.07.2024 për dhënien e pëlqimit* për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt "Harta Zonale e Komunes se Obiliqit 2024-2032" .

Andaj bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor neni 16 dhe 20, Udhëzimin Administrativ nr.05/2014 neni 7,8,10,11,12,13,14 dhe 15 si dhe në atë që u cek më lartë kërkojmë nga ana e juaj që të thirrni mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal për hapjen e shqyrtimit publik për projekt – " Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032 " përkatësisht t'a thirrni mbledhjen për dt.**02.08.2024 ditë e Premte** .

Me respekt .

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPSTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 02-020/01- 21833/24
Data / Datum / Date 26.07.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq – Opština Obilić - Municipality Obiliq
Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 12.1, nenit 17 shkronja (b), nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, neni 16 dhe 20 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, neni 7, 8,10,11,12,13,14 dhe 15 i Udhëzimit Administrativ MMPH –NR 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapësinor neni 14 dhe neni 72 pika 1.8 e Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 dt.25.04.2016, Kryetari i Komunës propozon që Kuvendi i Komunës në Mbledhjen e jashtëzakonshme të miratojë këtë:

**PROPOZIM**

**VENDIM**

**Për hapjen e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032**

Neni 1

Të miratohet ky propozim Vendim për hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të Planifikim Hapësinor – Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032.

Neni 2

Qëllimi i paraqitjes së këtij Propozim Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të Planifikim Hapësinor – Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032 të cekur si në nenin 1 të këtij Propozim Vendimi është që dokumenti të jetë i hapur për publikun ku ftohen qytetarët , ekspertët dhe palët e interesit për të parashtruar komentet apo sygjerimet para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapësinor- draft dokumentit Harta Zonale e Komunës së Obiliqit.
Autoriteti i Planifikimit përkatësisht Komuna e Obiliqit siguron dhe inkurajon pjesëmarrjen publike transparente në procesin e planifikimit duke ofruar qasje publike në çdo fushë të zhvillimit hapësinor në tërë territorin e Komunës të planifikuar në këtë dokument , në të dhëna, harta, grafikone dhe çdo kërkesë që e parashtrojnë palët e interesit lidhur me këtë dokument.

2.1.Ekspozimi i projektit "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032" parashihet të bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës.

2.2. Për të promovuar gjithë përfshirjen dhe transparencën parashihen të mbahen prezantime shtesë sipas planit të organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.

2.3.Për të gjitha prezentimet publike parashihet të mbahet procesverbali.

2.4.Shqyrtimi publik i projekt "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032" do të zgjas 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.5.Shpallja e shqyrtimit publik të projektit "Harta Zonale e Komunsë Obiliqit 2024-2032" do të bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqes zyrtare të Komunës dhe në mediat televizive publike.



2.6.Projekti "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032" do të jetë i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 3

3.1.Ky projekt do t'i nënshtrohet vërejtjeve,komenteve dhe sygjerimeve të publikut para se të finalizohet.

3.2.Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sygjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin Publik.

Neni 4

Shqyrtimi i projektit "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032" do të organizohet nga Komuna e Obiliqt në suaza të Kompetencave të përcaktuara me Ligj.

Neni 5

5.1.Me këtë propozim vendim duhet të parashihet sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit Publik të projektit "Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032".
5.2.Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit Publik.

Neni 6

Pas hyrjes në fuqi të këtij propozim Vendimi Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ MMPH –NR 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapësinor do të bëjë hapja e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit.

Neni 7

Pas miratimit të këtij Propozim Vendimi, për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës .

Datë:26.07.2024

**Kryetari i Komunës**
**Xhafer Gashi**



Poashtu është bërë njoftimi publik për të gjithë qytetarët dhe të gjitha palët e interest lidhur me hapjen e shqyrtimit publik për draft dokumentin e Hazrtës Zonale të Komunës së Obiliqit 2024-25032.

Janë vendosur njoftime nëpër vende ku ka levizje si në sheshe objekte shkollore, fetare, biznese e në çdo vend ku ka fluks të madh të qytetarëve në mënyrë që të jenë të njoftuar lidhur me finalizimin e këtij dokumenti.




D.D.D
D.D.D
Informatë me rëndësi
KEK


EXIT
KONKURS




SHKOLLA FILLORE E MESME E ULËT
"HASAN PRISHTINA"
MILLOSHEVË
REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr Br No 05-104/02-01274/24
Nr i Lj / Br sv / Nr pg
Data / Datum / Date 26.07.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq – Opštine Obilić - Municipality Obiliq
Zyra e Kryetarit

Bazuar në Ligjin e Planifikimit Hapësinor Nr.04/L-174, UA Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës dhe UA Nr.05/2014 për përgjegjësit e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Komuna e Obiliqit ju fton në :

**SHQYRTIM PUBLIK**
**Për :Propozim Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032**
**Data:02.08.2024**
**Vendi: Objekti i Komunës së Obiliqit**

Prezantimi i dokumentit nga Komuna e Obiliqit do të mbahet më datën 02.08.2024 në ora 11$^{00}$ në objektin e Komunës së Obiliqit ( salla e Kuvendit)

Komuna e Obiliqit ka hartuar Propozim Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032, ku si bartëse e këtij procesi është Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronës dhe Kadastrit në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale dhe kompaninë "INSI" me seli në Prishtinë. Për finalizimin e dokumentit para aprovimit final, ky Propozim document prezentohet dhe pastaj shpallet në shqyrtim publik për 30 ditë para qytetarëve dhe të të gjitha palëve të interesit.
Komuna është e përkushtuar të bashkëpunoj ngushtë me të gjitha palët e interesuara që janë të gatshme të kontribojnë në fuqizimin përgaditjen e këij dokumenti të planifikimit hapësinor. Andaj ju ftojmë që të jeni pjesë e këtij shqyrtimi dhe diskutimi publik, ku pjesëmarrja dhe kontributi juaj do të mundësoj një planifikim të mirfilltë duke ndikuar në përmirësimin e jetës dhe zhvillimin e të gjitha proceseve në komunën tonë.
**Dokumentin mund ta gjeni në linkun: https://kk.rks-gov.net/obiliq/urbanizem/ si dhe do të jenë të ekspozuara hartat në hollet e objektit të komunës .**
**Shqyrtimi publik do të zgjas 30 ditë nga data 02.08.2024-02.09.2024, ku të gjithë të interesuarit mund të japin komente, vërejtje apo sygjerime, të cilat do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe korrektësi të plotë. Komentet , vërejtjet dhe sygjerimet e juaja mund t'i dorëzoni zyrtarisht në mënyrë fizike në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Pronës dhe Kadastrit, apo përmes formës elektronike në email: komuna.obiliq@rks-gov.net qshq.rks-gov.net dhe Arben.berisha@rks-gov.net .**

**Drejtori i DPUPK-së**
**Arben Berisha**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr Br No 05-104/02-01274/24
Nr i Lj / Br sv / Nr pg
Data / Datum / Date 26.07.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq – Opštine Obilić - Municipality Obiliq
Zyra e Kryetarit

Na osnovu clana Zakona e Planifikimit Hapësinor Br.04/L-174, UA Nr.24/2015 o elementima I osnovnih zahteva za pripremu, izvrsenje I monitoriranje Zonalna Mapa Opstine i AP Br.05/2014, i odgovornosti ovlascenih za planiranje plana I procedure za ucescevanja gradjana u javnim skupovima za pripremu plana, Opstina Obilic, poziva na :

**Javnu Diskusiju**
**Za : Predlog Zonalna Mapa Opstine 2024-2032**
**Datum:02.08.2024**
**MESTO: Objektu Opstine**

Prezentiranje dokumenta od Opstine Obilic ce se odrzati dana 02.08.2024 u 11$^{00}$ casova u objektu Opstine Obilic ( u sali SO)

Opstina Obilic je pripremila Predlog Zonalne Mape Opstine 2024-2032, koja je nadzorna za process Direkcija, za Planiranje urbanizma, Imovinu I kadastar zajedno sa sektorijalnim direkcijama I kompanijom "INSI" sa sedistem u Pristini.
Za finalizaciju dokumena pre finalnog usvojenja, ovaj predlog-dokumenat ce biti na javnom razmotrenju u roku od 30 dana, pred gradjanima I drugim interesovanim licima
Opstina je obavezna da saradjuje sa svim interesovanim strankama koje su spremne da saradjuju za pripremu dokumenta koji ce se privesti u praksi.
Prema tome se pozivate da budete deo ovog javnog razmatranje i javne diskusije, gde vas doprinos ce igrati ulogu na planiranje i procesu boljeg zivota u gradu.
**Dokumenat ce te naci na linku: https://kk.rks-gov.net/obiliq/urbanizem/ i bice ekspozirana I karte u holu skupstine.**

**Javna diskusija ce trajati 30 dana od dana 02.08.2024-02.09.2024, gde svi interesovani mogu dati svoje komentare, koje ce se razmotritit profesionalno I punom koreksijom. Vase primedbe, sugestije mozete dostaviti sluzbeno u Direkciji za Planiranje Urbanizma, Imovinu I Kadastar ili na email: komuna.obiliq@rks-gov.net qshq.rks-gov.net i Arben.berisha@rks-gov.net .**

**Direktor za DUPIK**
**Arben Bersha**

Seanca e mbledhjes së KK Obiliq është mbajtur me datën 02.08.2024, në këtë seancë ishin të pranishëm,Kryetari i komunës, të gjithë përfaqësuesit e asamblesë komunale, drejtorë, zyrtarë, e të gjitha palët tjera të interesit.

Asambleistëve i'u është dërguar materiali në CD-të dhe përmes emaileve, në mënyrë që të jenë të informuar për punën e deritanishme që është bërë rreth hartimit të këtij dokumenti.

Të gjithë asambleistët pa dallim ishin për hapjen e shqyrtimit publik dhe kështu votuan të gjithë për marrjen e vendimit për hapjen e shqyrtimit publik.

U bë prezentimi i dokumentit ku ishin pjesmarrës një numër i konsiderueshëm i qytetarëve dhe palëve të interest.

Pyetjeve të shumta si nga qytetarët ashtu edhe nga deputetët iu përgjigjën drejtori I DPUPK-së Arben Berisha si kryetar I grupit punues dhe kordinator I këtij projekti si dhe përfaqësuesit e kompanisë INSI si hartues të projektit.

**Komuna e Obiliqit- Faqja Zyrtare**
3 days ago ·

Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme

Me kërkes të kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, inicuar nga Drejtoria e për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër.
Kuvendi Komunal i Obiliqit,ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme.I pranishëm në këtë seancë ishte edhe Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Mjekiqi Kabashi, e cila shpalosi rendin e ditës dhe pas miratimit të pikës së propozuar është vijuar me trajtimin e saj.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1."Hapja e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032".

Ku pas elaborimit nga ana e Drejtorit të DPUKP-së, Arben Berisha dhe kompania INSI për përmbajtjen e "Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032", anëtarët e Kuvendit votuan me 17 vota për hapjen e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032".

Ky dokument do të jetë në shqyrtim publik prej 30 ditësh, ku pas shqyrtimit nga ana e qytetarëve dhe njohësve të kësaj lëmie do të vazhdohet tutje në procedura sipas rregulloreve dhe ligjeve.

Kryetari Gashi, ka falënderuar për angazhimin gjithë grupin punues komunal dhe anëtarët e KK Obiliq për kontributin e dhënë!

Zyra për informim,Obiliq.








Kështu që në këtë mbledhje KK Obiliq mori Vendim për Hapjen e Shqyrtimit Publik për draft dokumentin e HZK-së.

Pasi kërkesat për sqarime të palëve lidhur me këtë dokument ishin të shumta, atëherë është shtyer afati për shqyrtim publik të dokumentit deri më datën 17.09.2024.

Marrja e këtij Vendimi për shtyerje të diskutimit publik lidhur me draft dokumentin e HZK-së është publikuar si në Web faqen e Komunës ashtu edhe në rrjetet sociale të Komunës.



05-104-02-25237-24

03.09.2024

**REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË/OPŠTINAOBILIĆ – KOSOVO/MUNICIPALITY OF OBILIQ – KOSOVO**

**Drejtoria e Planifikimit Urban, KadastërdhePronë**

Bazuar ne nenin 62 pika 62.3 të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40,nenit 99 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031 dhe nenit 91 pika 1 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 dt.25.04.2016, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban,Kadastër dhe Pronë me datë **03.09.2024** mori këtë

**V E N D I M**

**1.Shtyhet** – afati për shqyrtim Publik të Draft dokumentit t ë Hartës Zonale të Komunës së Obiliqit 2024-2032, për paraqitjen e ankesave, vërejtjeve apo sygjerimeve nga ana e qytetarëve të Komunës së Obiliqit.

**2.Afati** për paraqitjen e ankesave, vërejtjeve apo sygjerimeve nga ana e qytetarëve të Komunës së Obiliqit mbyllet më datë:**17.09.2024** ditë e **Marte**.

**3.Obligohet**-Zyra për Informim që këtë Vendim t'a publikoj në faqen zyrtare të Komunës.

**A r s y e t i m**

Drejtoria për Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë duke analizuar rrethanat dhe kërkesat e shumta të qytetarëve për dhënien e sqarimeve rreth draft dokumentit të HZK-së së Komunës së Obiliqit 2024-2032, për shkak se paraqet një qështje mjaft komplekse rreth realizimit të kërkesave të tyre, ka parë të arsyeshme shtyerjen e afatit fillestar për paraqitjene ankesave, vërejtjeve apo sygjerimeve nga ana e qytetarëve të Komunës së Obiliqit.

Andaj nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Drejtori DPUKP-së**

**Arben Berisha**

05-104-02-25237-24

03.09.2024

**REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË/OPŠTINAOBILIĆ – KOSOVO/MUNICIPALITY OF OBILIQ – KOSOVO**

**Direkcija za urbanizam, katastar i imovinu**

Na osnovu člana 62 tačka 62.3 Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-40, člana 99 Zakona o opštem upravnom postupku br. 05/L-031 i člana 91 tačka 1 Statuta opštine Obilić br. I-34 od 25.04.2016, direktor Direkcije za urbanizam, katastar i imovinu dana 03.09.2024. donosi sledeću:

**ODLUKU**

**1. Odlaže se rok** za javno razmatranje nacrta dokumenta **Zonske mape opštine Obilić 2024-2032,** za podnošenje žalbi, primedbi ili sugestija od strane građana opštine Obilić.

**2. Rok za podnošenje žalbi,** primedbi ili sugestija od strane građana opštine Obilić ističe: **17.09.2024, utorak.**

**3.** Kancelarija za informisanje je dužna da ovu Odluku objavi na zvaničnoj internet stranici Opštine.

**Obrazloženje**

Direkcija za urbanizam, katastar i imovinu, analizirajući okolnosti i brojne zahteve građana za pružanje pojašnjenja o nacrtu dokumenta ZMO Opštine Obilić 2024-2032, jer predstavlja veoma složeno pitanje u pogledu realizacije njihovih zahtjeva. smatra razumnim da odloži početni rok za podnošenje žalbi, primedbi ili sugestija građana opštine Obilić.

Stoga je, iz iznetog, odlučeno kao u dispozitivu ove odluke.

**Direktor DUPKI**

**Arben Berisha**

Adem haliti

Yesterday, 14:56

Merita Simnica; Festina Preniqi; Arben berisha

Label: DelFiveYOldEm (5 years) Expires: 02/09/2029 14:56

https://kk.rks-gov.net/obiliq/wp-content/uploads/sites/22/2024/09/vendim-shtyerja-e-afatit.pdf

Publik eshte ne web faqe vendimi linku me nalte .

...

Republika e Kosoves
Obiliq

kerko ketu ALB ▼



TË GJITHA
APLIKACIONE
KONKURSET
NJOFTIMET
THIRRJE PER PROPOZIME

# KONKURSET & NJOFTIMET

2024 2023 2022 2021 2020 2019 Tjera

**Pjesa Hartografike e Hartave Zonale të komunes së Obiliqit 2024-2032 - PJESA II** PDF
*publikuar:29/07/2024*

**Pjesa Hartografike e Hartave Zonale të komunes së Obiliqit 2024-2032** PDF
*publikuar:29/07/2024*

**Njoftim për diskutim Publik Hortat Zonale 2024-2034** PDF
*publikuar:29/07/2024*

**Njoftim,Faza e dytë dezinsektimi hapësinor** PDF
*publikuar:23/07/2024*


kk.rks-gov.net/obiliq/
Republika e Kosoves
Obiliq
kerko ketu
ALB
Obiliq Komuna Kuvendi Drejtoritë Lajmet Prokurimi Qyteti Kontakti Investimet Konkurset & Njoftimet Projektet Raporto
e-Prokurimi e-Prokurimi Njoftimet Konsultimet Publike
Misioni & Vizioni
A A
Kyçu
Regjistrohu
Mirësevini në Obiliq
Faqja e Komunës së Obiliqit do të jetë faqja, në të cilën qytetarët e komunës sonë, por edhe më gjerë, mund të informohen për punën dhe të arriturat tona, por edhe me preokupimet tona dhe të qytetarëve tanë!
Numri Personal
Fjalëkalimi
Kyçu
Harta Zonale e Komunes së Obiliqit 2024-2032
|Forma e aplikacionit


kk.rks-gov.net/obiliq/
Albanian
English
Google Translate
Republika e Kosoves
Obiliq
kerko ketu
ALB
Obiliq Komuna Kuvendi Drejtoritë Lajmet Prokurimi Qyteti Kontakti Investimet Konkurset & Njoftimet Projektet Raporto
e-Prokurimi e-Prokurimi Njoftimet Konsultimet Publike
Misioni & Vizioni
A A
Kyçu
Regjistrohu
Mirësevini në Obiliq
Faqja e Komunës së Obiliqit do të jetë faqja, në të cilën qytetarët e komunës sonë, por edhe më gjerë, mund të informohen për punën dhe të arriturat tona, por edhe me preokupimet tona dhe të qytetarëve tanë!
Numri Personal
Fjalëkalimi
Kyçu
Njoftim për diskutim Publik Hortat Zonale 2024-20... |Forma e aplikacionit

Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastrit dhe Pronës është angazhuar në maksimum që për të gjithë qytetarët të jetë e hapur gjatë tërë periudhës sa do të jetë HZK në shqyrtim publik.

Ka pregaditur fletoren e cila ka qenë në tavolinën në hyrje të komunës, formularët në zyrën pritëse, formularët në zyren e urbanizmit ku qytetarët në ata formular dhe në fletore do të mund të paraqesin vërejtjet, sygjerimet dhe komuntet lidhur me këtë dokument.

Këta formular kanë pasur mundësi t'i shkarkojnë edhe nga Web faqja e Komunës te vegza njoftimet dhe konkurset.

Formularët do të mund t'i dërgohen zyrës së Urbanizmit zyrtarisht përmes zyrës pritëse apo në dy email adresat të cilat janë të prezentuara në njoftim të shqyrtimit publik.






Sa vien toka
Koliko vredi vaša zemlja?




Sa vlen toka juaj?
Koliko vredi vaša zemlja?


ZOTIM

Gjatë këtij afatit nga data 02.08.2024 e deri më datën 17.09.2024, qytetarët janë interesuar të marrin informata direkte lidhur me parcelat e tyre, kanë kërkuar nga stafi jonë që t'iu japim sqarime lidhur me zhvillimet në të gjitha fushat dhe ndërtimet.Poashtu hartat kanë qenë të ekspozuara në koridoret e objektit të Komunës, ku palët kanë pasur mundësi të marrin informata të cakta lidhur me parcelat e tyre.

Shqyrtimi publik ka përfunduar më datën 17.09.2024.

Më daten 24.09.2024 është mbajtur takimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave, ku ky komision është formuar nga kryetari i komunës me vendimin nr.02-020/01-23293/24 dt.14.08.2024.

REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OBILIQ
02-020/01-23293/24
14.08.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Komuna Obiliq
Opština Obilić - Municipality Obiliq

ZYRA E KRYETARIT
Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës ( nr. I-34 të dt. 25.04.2016), Draft –Dokumentin për Hartën Zonale për vitin 2024-32 te Komunës se Obiliqit, Kryetari i Komunës së Obiliqit, më 13.08.2024, mori këtë:

**VENDIM**

I. Miratohet vendimi për Emërimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, komenteve etj. lidhur me Draft –Dokumentin për Hartën Zonale për vitin 2024-32 te Komunës se Obiliqit, në këtë përbërje :

1. Arben Berisha- Kryetar i komisionit
2. Vlora Halimi , anëtare
3. Hamit Mjeku, anëtar
4. Eugen Mehmeti, anëtar
5. Valbona Preniqi, anëtare
6. Valmira Ibrahimi, anëtare
7. Zorica Spasiq, anëtare

II. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, komenteve etj. lidhur me Draft –Dokumentin për Hartën Zonale për vitin 2024-32 te Komunës se Obiliqit

III. Komisioni për punën e vetë do të mbajë procesverbal me te cilën do te informon Kryetarin e Komunës .

IV. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

T'i dorëzohet
- Kryetarit të Komunës
- Drejtorin e DPUPK.
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Xhafer Gashi

Gjithësej kanë qenë 9 (nëntë) kërkesa respektivisht ankesa:

1.Enver Gashi numri  i lëndës V-22394/2024 data 07.08.2024

2.Bekim Rama  numri i lëndës V-24507/2024 data 27.08.2024

3.KEK-SHA numri i lëndës V-24907/2024 data 30.08.2024

4.Valdet Ismajli numri I lëndës V-24853/2024 data 30.08.2024

5.JURISGUARD LAW FIRM SH.P.K. – përfaqësues I Ramadan Maloku data 02.09.2024

6.Enver Gashi numri I lëndës V-26263/2024 data 10.09.2024

7.Florim Tovërlani numri I lëndës V-27262/2024 data 16.09.2024

8.Shpresim Prestreshi numri lëndës V-27805/2024 data17.09.2024

9.Ismet Konushevci data 26.08.2024

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar nga Komisioi dhe për secilën kërkesë Komisioni ka vendosur të aprovohet apo të refuzohet.

Për çdo përgjigjëje është dhënë arsyetimi ku raporti i shqyrtimit publik do të publikohet në Web Faqen e Komunes vegza njoftimet dhe konkurset në shpallje publike per 5 (pesë) ditë ashtu siq parashihet me udhëzimin administrative të MMPH  05/2014 për përgjegjësit e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapsinor, **neni 12**.

Falenderojmë çdo qytetarë,shoqërin civile, bizneset,institucionet të cilët kanë kontribuar në finalizimin e këtij dokumenti në mënyrë direkte apo indirekte duke dhënë sygjerime, komente duke ardh fizikisht dhe duke u interesuar në lidhje me dokumentin që nga fillimi i hartimit  e sidomos gjatë kohës sa ka qenë dokumenti në shqyrtim publik.

Raporti detal i shqyrtimit të ankesave nga komisioni do te publikohet ne vijim së bashku me raportin i përfshin tërë procedurat që nga fillimi i  hapjes së shqyrtimit publik e deri në përfundimin të tij.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E OBILIQIT
REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA OBILIĆ
OBILIQ - OBILIĆ